



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E MBROJTJES SOCIALE, ARSIMIT, KULTURËS DHE SPORTEVE**  
**SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**  
**KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 1644 Prot.



**PROJEKT-VENDIM**  
Nr. 29, datë 19/05 /2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB-NË NR. 21, DATË 29.03.2024 “PËR  
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS TË  
BASHKISË PATOS”**

**KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2024 “Për njoftimin dhe Konsultimin Publik”, si dhe urdhërit nr. 281, datë 30.12.2025 “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”,

**PROPOZON:**

1. Të miratojë rishikimin e Programit të Transparencës të bashkisë Patos në përputhje me modelin e miratuar me urdhërin nr. 281, datë 30.12.2025 “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e Të Dhënave Personale.
2. Programi Transparencës përfshin modelin sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.
3. Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë dhe Koordinatorin për të Drejtën e Informimit.

**Koordinator për të Drejtën e Informimit**  
**Klevisa Zhapaj**

**Sekretar i Përgjithshëm**  
**Juela Shpata**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E MBROJTJES SOCIALE, ARSIMIT, KULTURËS DHE SPORTIT**  
**SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**  
**KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 1647 / Prot.  
11

Patos, më 19 / 10 / 2026

**RELACION**  
**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB-NË NR. 21, DATË 29.03.2024 "PËR**  
**MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS TË**  
**BASHKISË PATOS"**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" i ndryshuar si dhe urdhërit nr. 281, datë 30.12.2025 "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore" Bashkia Patos do të miratoj ndryshime në programin e Transparencës sipas formës dhe përmbajtjes në lidhjen nr. 1 bashkëlidhur.

Në kuadër të rritjes së standardeve të administrimit, përgjegjshmërisë dhe besimit publik, vlerësohet e domosdoshme zbatimi i Programit të Transparencës në institucionin e bashkisë Patos

Programi i Transparencës ka si qëllim garantimin e informimit të qytetarëve dhe palëve të interesuara mbi aktivitetin, vendimmarrjen, menaxhimin e fondeve dhe shërbimet që ofron institucioni. Zbatimi i këtij programi sjell një sërë përfitimesh të rëndësishme, si:

- Rritjen e besimit të publikut ndaj institucionit;
- Përmirësimin e komunikimit me qytetarët;
- Sigurimin e aksesit të lirë në informacion publik;
- Rritjen e përgjegjshmërisë institucionale;
- Përputhjen me kërkesat ligjore dhe standardet e administrimit të mirë.

Gjithashtu, Programi i Transparencës ndihmon në forcimin e integritetit institucional dhe krijon një klimë më të hapur e bashkëpunuese ndërmjet institucionit dhe qytetarëve.

Ndryshimet përkatëse janë:

Në PT' shtohet një fushë e re, Fusha 8 "Këshilli Bashkiak", dedikuar veprimtarise se këtij organi të rëndësishëm. Në këtë fushë kërkohet të hidhet informacion lidhur me 8 nënfusha:

- Informacion rreth këshilltarëve;
- Informacion rreth komisioneve;
- Kuadri rregullator i keshillit te NJVV;
- Mbledhjet e Këshillit;
- Konsultimet publike;

- o Vendimet e Keshillit të NjVV;
  - o Kërkesat dhe pergjigjet drejtuar Keshillit te NJVV;
  - o Veprimtaria e Keshillit, komunikimi me publikun dhe aspekte të tjera.
1. Fusha 1 “Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë” riformatohet në 6 nënfusha, pasi nënfushat 2 dhe 3, tashmë përfshihen në fushën 8.1)
  2. Fusha 3 “Për kerkesa per informim” riformatohet në 4 nënfusha:
    - o Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit;
    - o Standardet dhe procedurat që duhen ndjekur për të bërë kerkesë për informim dhe ankesës;
    - o Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve;
    - o Tarifa për dhënien e informacionin (nëse ka).

Për ndjekje dhe zbatimim ngarkohet Administrata e Bashkisë dhe Koordinatori për të Drejtën e Informimit.

**Koordinator për të Drejtën e Informimit**  
**Klevisa Zhapaj**

